



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË



Nr. 883/7 Prot

Tiranë, më 13.12.2021

Nr. 883 Dosje

URDHËR

(PËR VENIEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE)

Drejtuar : Qendra Kombëtare e Biznesit Tiranë,

Unë, Haxhi Ismaili, me detyrën e Përmbaruesit Gjyqësor, pranë Zyrës së Përmbarimit Privat "3H" SHPK, në referim të *Urdherit të Ekzekutimit Nr.477 prot date 29.09.2021 i Gjykates Administrative të Shkalles se Pare Durres*, kam vënë në ekzekutim këte urdhër, duke regjistruar në dosjen përmbarimore Nr.883 kërkesën e *Kreditorit- Dega e Doganes Durres* për vënie në ekzekutim të *Titullit ekzekutiv*, Vendimi per rikuperim me force te borxhit doganor Nr.89 prot date 15.02.2021 i Deges Doganore Durres, për *Debitorin- "BIT ITALIAN TECHNOLOGY" shpk me NIPT L71413023U me administrator Z. Ignazio Cassano*.

Pasi fillova procesin e ekzekutimit të detyrueshëm, duke i dërguar debitorit Lajmërimin për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimin që përmban Urdheri i Ekzekutimit në referim të neneve 517 dhe 518 të K.Pr.Civile,

KONSTATOVA Se :

Debitori- "BIT ITALIAN TECHNOLOGY" shpk me NIPT L71413023U me administrator Z. Ignazio Cassano ka marrë njoftimin e Lajmërimit për Ekzekutimin Vullnetar të Detyrimit dhe nuk i eshte përgjigjur respektimit të afatit dhe kërkesave të këtij lajmërimi.

Në këto kushte në referim të nenit 527 të K.Pr.Civile duhet të filloj ekzekutimin e detyrueshëm, duke vënë sekuestër mbi kreditë e debitorit "BIT ITALIAN TECHNOLOGY" shpk me NIPT L71413023U me administrator Z. Ignazio Cassano, në masën që do të jetë e nevojshme për plotësimin e detyrimit.


Përsa më sipër, në referim të neneve 36 pika (e), 37 pikat (b) dhe 53 (paragrafi i 1-rë) të Ligjit Nr. 26/2019 "Per Sherbimin Permbarimor Gjyqesor Privat",

Adresa: Bulevardi Zogu I, Sheshi Ferenc Nopçka, Ndertesa 6, Hyrja 10, Apartamenti 23, Tirane

Website: www.3-h.al

Cel. 0692099711

Email: shpgj\_3h@yahoo.com



## URDHËROJ

1. Qendra Kombëtare e Biznesit Tiranë, të bëjë bllokimin e kuotave dhe të drejtat që rrjedhin nga zotërimi aksioneve nga:

- **Subjekti:** – **“BIT ITALIAN TECHNOLOGY” shpk me NIPT L71413023U me administrator Z. Ignazio Cassano**

Për informimin, bllokimin e shitjes së aksioneve dhe tjetërsimit të aktivitetit dhe veprimet që duhet të kryeni pas marrjes së njoftimit të këtij urdhri në lidhje me debitorin e sipërpërmendur të njoftohem në rrugë zyrtare brenda afatit administrativ nga ana Juaj.

2. Personat që bëhen pengesë, brenda afatit të përgjigjes zyrtare, që nga dita e njoftimit të këtij urdhri, do të përgjigjen sipas dispozitave sanksionuese që parashikon Kodi i Procedurës Civile dhe Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, në lidhje me pengimin e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore apo të titujve ekzekutive, ku aplikohet sanksioni i gjobes në shumën 50.000 lekë në zbatim të nenit 606 të K.Pr.Civile si dhe kallëzim për pengim ekzekutimi në zbatim të nenit 320 të K.Penal.
3. Ky urdhër është i vlefshëm deri në një urdhër të dytë.
4. Ky urdhër mbahet në 4 (katër) kopje, dhe u njoftohet palëve të cilat kanë të drejtën e ankimit në gjykatë brenda 5 ditëve, nga dita e marrjes dijeni.

### ZYRA E PËRMBARIMIT PRIVAT “3 H” SHPK PERMBARUES GJYQESOR

Haxhi ISMAILI



Adresa: Bulevardi Zogu I, Sheshi Ferenc Nopçka, Ndertesa 6, Hyrja 10, Apartamenti 23, Tirane

Website: [www.3-h.al](http://www.3-h.al)

Cel. 0692099711

Email: [shpgj\\_3h@yahoo.com](mailto:shpgj_3h@yahoo.com)